



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 16-9699/16
Kaçanik, 29.04.2016

Në bazë të nenit 12, 17(e) të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), të nenit 6 lidhur me nenin 34.5 e Statutit të Komunës së Kaçanikut, si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 prill 2016, merr këtë:

V E N D I M

PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS TRUNGUT TË QARRIT (*Quercus cerris*) NË KAÇANIK I VJETËR SI MONUMENT I NATYRËS

1. Me këtë Vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Trungu i qarrit** (*Quercus cerris*) në fshatin Kaçanik i Vjetër, Komuna e Kaçanikut si monument i natyrës i karakterit botanik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të projeksionit të kurorës dhe zonës buferike prej 5m rreth projeksionit të kurorës, përfshinë sipërfaqen **prej 3 ari**.

1.2. Monumenti i Natyrës ka vlera estetike, turistike, historike dhe si i tille është i rrallë jo vetëm për territorin e Komunës së Kaçanikut, karakterizohet me kurorë të zhvilluar. Perimetri i tij sillet rreth 5.10m, diametri i kurorës 16m dhe lartësia 25m, mosha e trungut sillet rreth 350 vite. Trungu është i dëmtuar nga faktori antropogjen dhe kurora e tij është e krasitur në pjesën e poshtme.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në varrezat e fshatit Kaçanik i Vjetër, gjegjësisht në lagjen e Krasniqëve, në lartësinë mbidetare 539m, Zona Kadastrale Kaçanik i Vjetër, parcela nr. 969-0, me sipërfaqe 22209m², koordinatat LONG: 42.295080, LONG:21.227703, P.SH. Kuvendi Komunal Kaçanik me kulturë varreza.

3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III - të, Natural Monument / Natural Landmark – Monument i Natyrës.

4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

4.1.1. Prerja e trungut, thyerja e degëve, mbledhja e gjetheve apo fryteve, kositja e barit si dhe çfarëdo veprimtarie e cila ndryshon gjendjen e tanishme,

4.1.2. Ndezja e zjarrit në sipërfaqen e mbrojtur,

4.1.3. Mbjellja e bimëve me qëllim të gjelbërimit të sipërfaqes së mbrojtur,

- 4.1.4. Ndryshimi i pamjes së sipërfaqen së mbrojtur,
 - 4.1.5. Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqen e mbrojtur,
 - 4.1.6. Punimi (lëvrimi, shfrytëzimi) i tokës në sipërfaqen e mbrojtur dhe
 - 4.1.7. Aktivitetet të tjera të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime të Monumentit të Natyrës.
- 4.2. Në Monumentin e Natyrës lejohen:
- 4.2.1. Të gjitha masat e mbrojtjes biologjike-teknike të Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.
5. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:
- 5.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,
 - 5.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,
 - 5.3. Ndërrimi i kulturës,
 - 5.4. Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.
 - 5.4.1. Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.
6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Kaçanikut.
- 6.1. Kujdestari është i detyruar:
- 6.1.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
 - 6.1.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
 - 6.1.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.
7. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.
8. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.
9. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi i mëhershëm 01. nr. 16-30558/15, i datës 29.09.2015.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

